

Procedura e aplikimit për pajisje me pasaportë biometrike të Republikës së Kosovës sipas Udhëzimit Administrativ nr 16 / 2011

Procedura e aplikimit për pasaportë për personat mbi 16 vjeç:

Aplikuesi duhet të jetë prezent personalisht në QKRC dhe duhet të ofrojë dokumentet si në vijim :

- kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës
- dëshminë për pagesë
- pasaportën paraprake (nëse e posedon)

- Nëse pasaporta paraprake është e humbur duhet të ofrojë **edhe** raportin policor origjinal për humbjen e pasaportës më të ri se tre muaj si dhe dy fotografi jo më të vjetra se 3 muaj
- Nëse pasaporta paraprake është e dëmtuar duhet të ofrojë **edhe** pasaportën e dëmtuar

Tërheqja e pasaportës bëhet personalisht nga aplikuesi ose nga personi tjetër me autorizim origjinal të vërtetuar nga noteri apo organi kompetent.

Aplikimi për pajisje me pasaportë për personat (fëmijët) nën moshën 16 vjeçare

Aplikuesi (fëmija) duhet të jetë prezent në QKRC i shoqëruar nga të dy prindërit dhe duhet të ofrojë dokumentet si në vijim:

- çertifikatën e lindjes
- çertifikatën e shtetësisë
- çertifikatën e vendbanimit
- dëshmitë për identitetin e prindërve (letërnjoftim, pasaportë ose patentë-shoferi)
- dëshminë e pagesës

- Nëse njëri prind mungon duhet prezantuar autorizimin origjinal të vëltur nga noteri
- Nëse njëri prind është i vdekur fëmija shoqërohet nga prindi tjetër duke paraqitur çertifikatën e vdekjes

- Nëse prindërit janë të ndarë, duhet prezentuar vendimin e gjykatës për përkujdesje të fëmijës
- Fëmija nën kujdestari duhet të shoqërohet nga kujdestari (tutori)
- Nëse pasaporta paraprake është e humbur duhet të ofrojë **edhe** raportin policor original për pasaportën e humbur jo më të vjetër se 3 muaj;
- Nëse pasaporta paraprake është e dëmtuar duhet të ofrojë **edhe** pasaportën e dëmtuar
- Për ndërrimin e të dhënave (ndërrimin e emrit, mbiemrit etj) duhet të ofrojë vendimin për ndërrimin e të dhënave si dhe pasaportën ekzistuese.

Tërheqja e pasaportës bëhet personalisht nga aplikuesi i shoqëruar nga njëri prind ose vetem nga prindi duke prezentuar letërnjoftimin e tij / saj dhe certifikatën e lindjes së fëmijës.